



---

**Hapet thirrja për mobilitete stafi të UPT-së,  
në AGH University of Science and Technology, Poloni  
për pjesëmarrje në javën e 3-të ndërkombëtare të stafit  
në kuadër të Programit Erasmus+ KA107.**

Në kuadër bashkëpunimit midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe AGH University of Science and Technology, hapet thirrja për mobilitete për staf të Universitetit Politeknik të Tiranës, në AGH University of Science and Technology, për pjesëmarrje në javën e 3-të ndërkombëtare të stafit, në Universitetin AGH, Krakov, Poloni.

**Lloji i mobilitetit përfshin:** Pjesëmarrje në javën ndërkombëtare të trajnimit të stafit, në AGH, në datat 15-19 janar 2024.

**Fushat e aplikimit:** Bazuar në Marrëveshjen IIA Erasmus+ midis AGH dhe UPT, stafi akademik për mësimdhënie është nga: **FTI, FIE, FIM, FIN, FGJM, FIMIF.**

**Kohëzgjatja e mobilitetit:** 5 + 2 ditë, 15-19 janar 2024

**Numri maksimal i stafit për nominim:** 3 (staf akademik për mësimdhënie)

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës;
- Plani i propozuar i lëvizshmërisë, "Staff Mobility for Teaching, Mobility Agreement".
- Të paktën një nivel B2 i gjuhës angleze.

Për të shkarkuar formatin e "Staff Mobility for Teaching, Mobility Agreement" klikoni te: [Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](#) , aneks 4.

Aktiviteti u kushtohet lektorëve, profesorëve, shkencëtarëve, studiuesve dhe stafit tjetër akademik që dëshirojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre akademike, si dhe **të mbajnë leksione në kuadër të Programit Erasmus+ në universitetin partner.**

Aktiviteti do të jetë gjithashtu një mundësi e shkëlqyer për të shkëmbyer njohuri dhe përvojë në fushën e mobilitetit Erasmus+ dhe për të promovuar idenë e ndërkombëtarizimit.

Pjesë e axhendës do të jetë Dita e Partnerëve, një ngjarje unike ndërkombëtare e organizuar nga Zyra Erasmus e AGH – së, e cila shërben si një ngjarje interaktive **për të promovuar thirrjet e hapura të lëvizshmërisë dhe për t'u takuar ballë për ballë me studentët dhe anëtarët e stafit vendas.**

AGH, më datë 18 janar, ka planifikuar të organizojë një panair arsimor për studentët dhe stafin e AGH. Objektivi kryesor i panairit është të promovojë programin Erasmus+ dhe të inkurajojë anëtarët e komunitetit akademik që të marrin pjesë në program dhe të vizitojnë universitetet partnere.

Stafit të UPT – së, pjesëmarrës në këtë aktivitet, i kërkohet që **të përgatisë një prezantim që**



---

**promovon ofertën arsimore të UPT – së dhe të dërgojë paraprakisht materialet e duhura në AGH.**

Pas procesit të nominimit në UPT, stafi i nominuar duhet të plotësojë një formular regjistrimi.

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT:

**Deri më 20 nëntor 2023, ora 12.00**

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) , [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

**Key Action 1**  
**- Mobility for learners and staff -**

